



**SOS FSHATRA
E FËMIJËVE
SHQIPËRI**



SOS FSHATRA E FËMIJËVE, SHQIPËRI

TIRANË, MË, 09.04.2026

FTESË PËR OFERTË

**ME OBJEKT: DIZENJIM DHE PRODHIM I MATERIALEVE TË
VIZIBILITETIT**

PRILL 2026



1. HISTORIKU

Shoqata SOS Fshati i Fëmijëve Shqipëri është një organizatë sociale, jo-politike dhe jo fetare, që ofron kujdes afatgjatë me bazë familjare për fëmijët, të cilët kanë humbur kujdesin prindëror, apo që për arsye të ndryshme nuk mund të jetojnë në familjet e tyre biologjike.

SOS Fshati i Fëmijëve mbështet gjithashtu fëmijët dhe familjet në nevojë përmes projekteve komunitare, që synojnë zhvillimin e kapaciteteve të këtyre familjeve.

SOS Fshati i Fëmijëve është anëtare e Organizatës Ndërkombëtare, SOS Kinderdorf International, krijuar nga Herman Gmeiner në vitin 1949. Ajo është prezentë në shumë vende në botë në shërbim të fëmijëve, familjeve dhe komuniteteve.

Misioni ynë: Në krijojmë familje për fëmijët në nevojë, në i ndihmojmë ata që të ndërtojnë të ardhmen e tyre dhe marrim pjesë në zhvillimin e komuniteteve të tyre.

2. PËRSHKRIM I PROJEKTIT

SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri është duke zbatuar projektin Perspektiva që Mundësojnë Punësimin e të Rinjve – YEEP II, financuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, BMZ dhe Hermann-Gmeiner-Fonds Deutschland e.V, HGFD.

Ky projekt ka si objektiv kryesor integrimin socio-ekonomik dhe rritjen e mirëqenies të të rinjve vulnerabël në 5 vende të rajonit të Ballkanit, dhe respektivisht: Maqedonia e Veriut, Bosnje dhe Hercegovine, Serbi, Kosovë dhe Shqipëri.

3. OBJEKTIVI I FTESËS PËR OFERTË

Objektivi kryesor i kësaj ftese për ofertë është përzgjedhja dhe kontraktimi i një operatori ekonomik për dizenjimin dhe prodhimin e materialeve të vizibilitetit, në funksion të aktiviteteve të projektit “Perspektiva që Mundësojnë Punësimin e të Rinjve – YEEP II”.

4. SYNIMI DHE QËLLIMI I SHËRBIMIT

Nëpërmjet kësaj Ftese për Ofertë kërkohet që të marrim këtë shërbim nga operator ekonomik që do të sigurojë prodhimin e materialeve të vizibilitetit sipas specifikimeve të detajuara në formularin e ofertës financiare (Aneksi I) të cilat përmbushin kriterin e cilësisë.

5. MËNYRA E PJESËMARRJES NË TENDER

Ju lutemi jepni ofertën tuaj duke plotësuar:



- Ekstraktin e Regjistrimit Tregtar të lëshuar nga QKR brenda muajit të fundit.
- Fotokopje të certifikatës së regjistrimit si person i tatueshëm nga organi përkatës.
- Ofertën Financiare sipas listës së materialeve të përcaktuara në aneksin A, bashkë me Ftesën për Ofertë. Monedha e kërkuar për çmimet e produkteve është LEKË (ALL).
- Në çmim do të përfshihet përgatitja, dizejimi, transporti i produkteve në destinacionin SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri, Sauk Tiranë.
- Foto ilustruese të produkteve të ofertuara.
- Afati kohor i dorëzimit të produkteve është dy muaj nga data e nënshkrimit të kontratës nga të dyja palët.

6. EKSPERIENCA DHE KUALIFIKIMI I SIGURUESVE TË SHËRBIMIT

Kualifikimet e dëshiruara të Ofruesve të Shërbimit janë si më poshtë:

- Ofruesi i Shërbimit siguron që ka disponueshmërinë e një game të gjerë materialesh.
- Ofruesi i Shërbimit siguron dizejimin, personalizimin dhe prodhimin e materialeve me një cilësi të lartë.
- Ofruesi i shërbimit duhet të dërgojë foto/katalog të punimeve të mëparshme të kryera, të cilat i dorëzon së bashku me dokumentacionin e pjesëmarrjes në tender.
- Ofruesi i shërbimit duhet të lëshojë faturë të rregullt të fiskalizuar, e cila do të paguhet nëpërmjet transfertës bankare.
- 2–3 vite përvojë në fushën e materialeve promovionale

7. VLERËSIMI

Ofertat do të vlerësohen bazuar në përmbushjen e termave të referencës, përputhshmërinë me kriteret e kualifikimit dhe ofertën financiare më të favorshme.

8. DORËZIMI I OFERTËS

Jeni të ftuar të dorëzoni ofertën tuaj si dhe të gjithë dokumentet e kërkuara nëpërmjet e-mail-it zyrtar info@soskd.org.al deri më datë 22.04.2026.

Çdo ofertë e marrë pas datës së mbylljes së procedurës nuk do të pranohet.

Forma e komunikimit në rast se keni pyetje duhet të jetë me shkrim, nëpërmjet adresës zyrtare të email-it: info@soskd.org.al



SOS FSHATRAT
E FËMIJËVE
SHQIPËRI



Përgjigjet do t'i merrni gjithashtu, nëpërmjet formës elektronike
info@soskd.org.al

SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri nuk është përgjegjës për ndonjë kosto që lidhet me përgatitjen e Furnizuesit dhe paraqitjen e ofertës.

SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri inkurajon çdo ofrues shërbimi të mundshëm të shmangë dhe të parandalojë konfliktet e interesit.



[Shtojcë për t'u plotësuar nga Ofertuesi]

FORMULARI I OFERTËS

Emri i Ofertuesit _____,

Qyteti: _____

Për: SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri

* * *

Procedura e prokurimit

DIZENJIME DHE PRODHIM MATERIALE VIZIBILITETI –YEEP II

Përshkrimi i artikullit	Njësia	Sasia	Çmimi/Njësi	Çmimi Total (përfshirë TVSH)
Jewellery Box - Mbajtje bizhuje, Mambo, ø 0.79x4.1 cm	copë	50		
Çanta plazhi, pambuk i riciklueshëm 170x90 cm, 180g/m2	copë	50		
Peshqir plazhi pambuk i riciklueshëm 150x210 cm, 180g/m2	copë	50		
Çadra portative, ø 95x100 cm	copë	50		



Poliestër, boshti metalik				
Stilolapsa me logo Me printim në një rën anë të tre logove me ngjyra	copë	500		
Termus çelik inoks 550 ml, ø 0.7x26.5 cm	copë	50		
Çantë me pambuk të ricikluar 120g/m2 38x42x8 cm	copë	50		
Çantë freskuese me lidhëse. Pambuk i ricikluar 140 g/m2/Alumini	copë	50		
Çantë material felt / shajak, plastikë RPET e ricikluar 40x42x15 cm	copë	50		
Çantë laptop felt / shajak të prodhuar nga material i ricikluar RPET.	copë	50		
Charger, wireless 10W ø 10x0.9 cm	copë	50		
Set gotash. Çelik inox i ricikluar. 2 copë 80 ml.	copë	50		



Çantë me lidhëse. Poliestër plastikë e ricikluar RPET. 34x42 cm	copë	50		
Varëse çelësash shumë-funkionale. Alumini 1.2x6.2x1.5cm.	copë	50		

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____